

MUSINE KOKALARI

vetëdija e shkrimit

dhe e qëndresës



KONFERENCA SHKENCORE

MUSINE KOKALARI
vetëdija e shkrimit
dhe e qëndresës

BOTIM NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË LINDJES SË MUSINE KOKALARIT

Titulli:

Konferenca shkencore "Musine Kokalari: vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës"

Botues:

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës

Përgatiti:

Prof. Dr. Persida Asllani

Redaktore:

Loreta Loli

Dizajn:

Rudina Dahri

© Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

ISBN: 978-9928-4494-0-5

ISBN: 978-9951-13-076-9

Parathënie

Bashkëpunimi i vijueshëm mes dy Bibliotekave tona Kombëtare është pasuruar vitet e fundit me organizime të përbashkëta veprimtarish kulturore, që synojnë thellimin e mëtejshëm të shkëmbimit të informacionit dhe njohjes me aspekte specifike të kulturës sonë, e kryesisht me autorë të rëndësishëm, veprat e të cilëve, teksa ushqejnë rrjedhën tonë të përbashkët kulturore, paraqesin një pasuri më vete në fondet e njëres bibliotekë ose tjetrës. Ky shkëmbim i vazhdueshëm, na lejon të pasurojmë dijen tonë mbi to dhe vlen njëkohësisht si një ftesë miqësore ndaj studiuesve dhe universitarëve të të dyja vendeve, për të bashkuar energjitë në një studim të ri bashkëkohor e të përbashkët të tyre.

Rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm është edhe ky vëllim i përbashkët që prezanton sot punën e dy institucioneve tona si dhe të studiuesve të shumtë përgjatë vitit 2017, teksa i kushtuam një vëmendje të veçantë figurës emblematike të shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar Musine Kokalari.

Veprimtaritë tona publike kushtuar Kokalarit e patën filluesën më 10 shkurt të 2017-s në Tiranë, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, pikërisht në kremtimet e 100-vjetorit të saj të lindjes përmes konferencës shkencore e ekspozitës “Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës”, për të vijuar edhe gjatë Javës së Bibliotekave në Kosovë, në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani”, e për t’u përmbyllur tashmë me këtë botim të akteve të konferencave tona së bashku me aneks-albumin që paraqet elementet vizuale që dokumentuan e shoqëruan ekspozitat tona librore.

Kremtimet e 100-vjetorit të lindjes së shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar Musine Kokalari, përkuan gjithashtu me shpalljen e këtij viti si “Viti i Kujtesës” në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, me qëllim nxitjen dhe promovimin e çdo akti kujtese, veçanërisht atij ndaj viktimave të diktaturës komuniste. Ne besojmë se rivendosja në vend e kontributit por edhe dinjitetit të tyre njerëzor, është një domosdoshmëri për shoqërinë shqiptare, për emancipimin tonë të mëtejshëm, për vendosjen e piketave tona sa kulturore aq edhe politike

në ringritjen shpirtërore të një shoqërie demokratike të bazuar mbi vlerat më të mira dhe në respektin e dinjitetit njerëzor.

Duke ndërmarrë këtë homazh ndaj “Vetëdijes së shkrimit dhe të qëndresës” që përshkon jetën dhe veprën e Musine Kokalarit deri në frymën e saj të fundit, ne rikthyem në vëmendje të publikut pasurinë letrare, erudicionin e thellë dhe qëndresën e lartë morale në rrethanat më të skajshme të jetës nën dhunën e persekutimit komunist.

Ne e kërkojmë lirinë jashtë vetes, ndërsa ajo gjendet brenda nesh - pohonte në shënimet e veta studentore gjatë viteve '40 zonjushë Musine Kokalari! Është pikërisht kjo liri brendashkruar qenies së saj që i dha shtysën e energjinë të hynte në letrat shqipe me zë e penë unike, që përcillte ligjërimet e munguara femërore në girin e letrave shqipe. Po kjo liri i dha forcën dhe dinjitetin e pashembullt për t'u shfaqur me aureolën e një ikone martirësh në gjyqin komunist kundër saj. Persekutorët nuk ia falën dot kurrë (as në ditët e tyre të vdekjes) vetëdijen e saj të lirisë: të qubeshe Musine Kokalari, të botoje artikuj e libra, të studioje e të diplomoheshe për letërsi në Universitetin e Romës, të themeloje Partinë e parë Socialdemokrate Shqiptare, të botoje “Zërin e Lirisë” dhe të kryesojë grupimin e parë antikomunist të opozitës shqiptare. Të ishte e bukur, e talentuar, inteligjente, e kultivuar dhe me kurajë intelektuale në vitet e Regjimit Komunist përbënte diçka të pafalshme!

Shkrimtarë e intelektualë të njohur e admiruan dhe e çmuan si një thesar njerëzor: Sotir Kolea, Aleksandër Xhuvani, Lasgush Poradeci, Zijaudin Kodra, Ernest Koliqi, Karlo Tagliavini etj. Mitrush Kuteli shpallte më 1944 se “... Musine Kokalari afirmohet në rangun më të mirë të letërsisë shqipe, jo si relativitet femëror, si mund ta shohë dikush, por si vlerë absolute”. Në vitin e vdekjes së saj, më 1983, vetëm Ibrahim Rugova pati vetëdijen letrare e politike të shkruante për të dhe të botonte diçka nga vepra.

Sot, vetëm leximi i shkrimeve të Musinesë mund t'u kethejë kuptimin e bukur këtyre titujve: T'isha një lule, Siç më thotë nënua plakë, Nënua plakë në Romë, Rreth Vatrës, ... sa u tund jeta, Jeta ime universitare etj.

Me këtë mision iu rikthyem veprës së Kokalarit gjatë seancave të ndryshme të konferencës sonë të përbashkët me titull “Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës”. Studiuues të letërsisë e filologjisë shqipe, filozofë e antropologë, historianë, arkivistë e bibliografë, sprovuam leximet e tyre si te vepra ashtu dhe te faktet mbresëlënëse të jetës së saj. Aktet e kësaj konference ndërkombëtare, me pjesëmarrje të gjerë studimesish nga Universitetet Italiane, Universiteti i Tiranës, i Prishtinës, i Gjirokastrës etj, rreken të ndriçojnë dy tiparet thelbësore të figurës së

Musine Kokalarit: atë të vetëdijes së shkrimit, si akt themelues i veprës së saj letrare; dhe atë të vetëdijes së qëndresës përballë dhunës e persekutimit absurd komunist si akt themelues i rezistencës intelektuale e qytetare.

*Kontributet e studiuësve në këtë botim janë grupuar sipas afërsisë disiplinore ose tematike me qëllim që të mund të vihen në pah edhe perspektivat e larmishme që nxisin ndër studiuës vepra e jeta e Kokalarit. Të vetëdijshëm se ky botim është i pari në llojin e tij, menduam ta pasurojmë edhe me botimin e një grupi shkrimesh të tjera që nuk ishin pjesë e drejtpërdrejtë e konferencës sonë. Ato variojnë nga shkrimi i famshëm kritik i Lasgush Poradecit për veprën *Siç më thotë nënua plakë*, te eseja mbi fotografinë e fundit të Kokalarit shkruar posaçërisht për këtë botim nga poeti e piktori Parid Teferiçi, e deri te artikuj të tjerë shkencorë që u sollën në këtë pjesë të dytë të botimit të akteve me qëllim pasurimin e leximeve mbi veprën e saj.*

Ndërsa në pjesën e tretë ky botim pasurohet nga një përzgjedhje imazhesh ilustruese e dokumentuese me të cilat u ndërtuan disa tipe ekspozitash mbi të, nga ato librare deri te ekspozitat virtuale, në Tiranë, Prishtinë, Romë, Milano etj. Këto ekspozita kanë sjellë për publikun dëshmitë e fillimeve letrare, më pas botimet e para të veprave të plota të Musine Kokalarit, si shkrimtarja e parë në letrat shqipe, dhe kanë vijuar me pjekurinë e saj si qytetare e person politik, si themeluese e Partisë Socialdemokrate Shqiptare dhe intelektuale e shquar. Një vend të rëndësishëm ze edhe dëshmia e persekutimit ekstrem por edhe e qëndresës së saj të pashembullt në emër të demokracisë dhe dinjiteti njerëzor.

Le të jetë ky botim një homazh për të e përmes saj një nderim për vetëdijen mbi shkrimin e mbi lirinë, të cilën ajo nuk e humbi për asnjë çast të jetës së saj. Në mbyllje, dëshirojmë të pobojmë se pa shkrimet e Musine Kokalarit letërsia shqipe sot do të ishte më e varfër, pa kurajën dhe vetëdijen për lirinë të Musine Kokalarit kuptimi ynë për lirinë dhe qëndresën (edhe aty ku ajo duket e pamundshme), do të ishte më i zbehtë dhe më i thyeshëm.

Prandaj dhe ky botim është vetëm fillimi i një vargu të gjatë studimesh e monografish që janë tashmë në proces e sipër hartimi e botimi kushtuar veprës dhe figurës së saj. U shprehim mirënjohjen tonë të gjithë kontribuuesve shkencorë të këtij vëllimi që na mundësuan të hidhnim së bashku hapin e parë. Ju faleminderit!

Persida Asllani dhe Fazli Gajraku



musinakalari

EKSPOZITA DHE KONFERENCA SHKENCORE

Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës

në 100-vjetorin e lindjes
së shkrimtares së parë shqiptare dhe intelektuales së shquar



BKSH, Salla shkencore, 10 shkurt 2017, ora 10:00



PËRMBAJTJA E LËNDËS

AKTET E KONFERENCËS SHKENCORE

Prof.As. Dr. Mauro GERACI - Universiteti i Mesinës - Itali <i>Musine Kokalari dhe fuqia e ëmbël e poezisë: letërsia, autobiografia dhe antropologjia</i>	15
Prof. Dr. Ardian NDRECA - Universiteti Urbanian, Vatikan <i>Musine Kokalari: provimi i jetës i një “zemre mendimtare”</i>	31
Prof. Dr. Dhurata SHEHRI - Universiteti i Tiranës <i>Musine Kokalari: Vetëdija e shkrimit</i>	41
Dr. Kujtim RRAHMANI <i>Musine Kokalari: hi e hir i një fustani</i>	47
Prof. Dr. Persida ASLLANI - Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë <i>“Nënua plakë në Romë”- aventura romane e zemrës shqiptare</i>	61
Dr. Albanë MEHMETAJ - Universiteti i Prishtinës <i>Kokalari për Kokalarin</i>	81
Dr. Femi ÇAKOLLI <i>Përralla dhe teologjika në veprën e Musine Kokalarit</i>	103
Doc. Dr. Agron TUFA - Universiteti i Tiranës Msc. Elvana ZAIMI <i>Kodi i ligjërit bisedimor në prozën e Musine Kokalarit</i>	111
Msc. Blerina ROGOVA-GAXHA - Universiteti i Prishtinës <i>Musine Kokalari: Gruaja</i>	117

Simonetta CEGLIE

“Një jetë e lehtë, e këndshme dhe plot ëndrra”: vitet e Musine Kokalarit në “La Sapienza”
mes kujtimeve dhe dokumentit 123

Uran BUTKA - Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”

Persekutimi shtetëror i Musine Kokalarit 151

Dr. Dorian KOÇI -Muzeu Historik Kombëtar

“Muza” e Rezistencës Antikomuniste 163

Brunilda DASHI -Universiteti La Sapienza

Instituti i Studimeve Shqiptare

Veçori gjuhësore në veprat letrare të Musine Kokalarit 173

Prof. asoc. Mimoza ZEKAJ - Universiteti i Gjirokastrës

Vlera e leksikut dialektor e krabinor në krijimtarinë e M. Kokalarit 197

KONTRIBUTE TË TJERA PËR FIGURËN E MUSINE KOKALARIT

Parid TEFERIÇI 209

Lasgush PORADECI 211

Nexhat HAKI

Talente femrore 215

Me rasën e librit “Rreth vatrës” të Musine Kokalarit 217

Dilo Lefter

Siç më thotë nënua plakë 221

Musine Kokalari dhe Xhexhe Frosua 223

Prof. Dr. Persida ASLLANI - Universiteti i Tiranës	
<i>Identitetet femërore si ligjërim në prozën e Musine Kokalarit</i>	225
Prof. Dr. Mimoza KARAGJOZI KORE - Universiteti i Tiranës	
<i>Veptra e Musine Kokalarit, dëshmi etnolinguistike e Gjirokastrës së viteve '30, memuar i çmuar i ditëve të sotme</i>	245
Meliza KRASNIQI - Instituti Albanologjik, Prishtinë	
<i>Musine Kokalari përballë Migjenit</i>	255
Aleksandër ÇIPA	
Etnoteksti i shkrintares disidente (Ese)	273
ALBUM/EKSPOZITË VIRTUALE	278

Brunilda DASHI
Universiteti “La Sapienza” - Roma IV
Instituti i Studimeve Shqiptare

Veçori gjuhësore në veprat letrare të Musine Kokalarit

Në vitin 1948, kur Musine Kokalari dergjej padrejtësisht burgjeve të regjimit, jashtë Atdheut, albanologu austriak Maximilian Lambertz e rendit si të vetmen shkrimtare shqiptare në mes të një aradhe të tërë autorësh, që fillon me Buzukun e mbyllet me Migjenin. Fragmentet e zgjedhura nga veprat shqip të autorëve shqiptarë e arbëreshë, të përkthyer dhe gjermanisht, i shërbejnë Lambertzit si tekste leximi për Gramatikën e vet përshkruese të gjuhës shqipe, botuar në të njëjtin vëllim. Kokalarit i boton katër tregime nga libri *Siç më thotë nënua plakë* [Lambertz1 I: 328-339]. Një dhjetëvjeçar më pas, ai e këqyr me imtësi gjuhën e shkrimtares, veçanërisht veprat *Siç më thotë nënua plakë e ...sa u tund jeta (sic)*, duke e njëjtësuar me dialektin e Gjirokastrës [Lambertz2: 85]. Njësimi bëhet a priori, nuk ka hulumtime krahasuese. Pak vite më vonë, në 1966, gjuhëtari Menella Totoni, pas vjeljes së materialit gjuhësor in loco, boton një studim të gjerë rreth së folmes së Gjirokastrës. Totoni pohon se e ka parë shkrimin e albanologut, por nuk e pranon si pasqyrë të dialektit gjirokastrit, sepse “Materiali” ku është mbështetur (dy veprat e

Kokalarit), “nuk reflekton besnikërisht” atë të folme [Ttoni: 80].

Të dy gjuhëtarët arrijnë në përfundimet përkatëse, duke vëzhguar, njëri, vetëm veprën letrare, tjetri, kryesisht traditën gojore. Ky studim synon të përqsasë veprën me traditën për të qëmtuar elementet gjuhësore që vërtetojnë përkimet dhe mospërputhjet mes tyre dhe realizohet me analizën e tri veprave letrare të Autores: Siç më thotë nënua plakë [SM], Reth vatrës [RV] e ...sa u tund jeta [ST].

Kundrimi i prurjeve të penës së Kokalarit do të rezultonte i pjesshëm dhe aspak përfaqësues i personalitetit të saj të spikatur, nëse këqyrja e lentimit të mirëfilltë letrar në SM, RV e ST (teksti narrativ) nuk do të shoqërohej e ndërthurej me shqyrtimin e karakteristikave gjuhësore të artikujve të fjalorit në SM [F1] e në ST [F2] (teksti informues) dhe të pashënies [P] Duke mbaruar... në ST (teksti argumentues) [për terminologjinë tekstuale khs. Lala: 1491]. Pikërisht vëzhgimi gjithëpërfshirës i kësaj larmie tipologjike tekstuale orienton në përkufizimin e secilit variant gjuhësor të përdorur dhe në përcaktimin e lidhjes së ndërsjellë midis tyre, pra ndërmjet dialektit gjirokastrit dhe idiolektit letrar të Autores.

Fenomenet fonetike (ndonjëherë dhe morfonologjike) në veprat SM, RV e ST analizohen në këtë trajtesë të krahasuara me të dhënat e Altasit dialektologjik [AD] e me studimin e lartpërmendur të Totonit. Tradita gojore e regjistruar në këto vepra nuk është hulumtuar këtu, sepse shumë këngë janë variante të këngëve të botuara më parë te Visaret e Kombit (khs. III: 66 Kur hyn nusja te dhëndëri me ST 196; 67 Moj unaza rreth flori me ST 145-146; 76 Nusja prindve me ST 179; IV: 259 Mineja rëzës së malit me ST 123), prandaj për to nevojitet një klasifikim e studim më vete.

Vokalizmi. Sistemi zanor i veprave të analizuara, pra teksti narrativ, informues dhe argumentues, përbëhet nga të shtatë tingujt e shqipes letrare. Delabializimi i zanores së lartë të përparme y në gjegjësen i është fenomen fonetik i gjithmbarshëm në tekstin narrativ, tipik i dialektit gjirokastrit, saqë AD e jep me 6 zanore [AD, I: 86].

Regjistrohet te emrat: SM 40 birekun, RV 105 birekut, ST 8 diqane, 12 fitin, SM 6 të hira, 64 të dija, 19 të dizetat; te mbiemri pronor: SM 25 it 'yt' (nuk trajtohet në kategorinë e përemrit sepse shoqëron një emër, nuk e zëvendëson e nuk del në formën e shquar); te përemrat vetorë: SM 12 ti, 26 atire; te foljet: SM 3, 26 lipsen, 18 thihet, RV 93, 127 friu, ST 27 pështiu, 16 shtipi; dhe te numërorët: RV 93, ST 7 dizet, 7 diqint.

Shpesh kjo dukuri nuk ka vazhdimësi për kategori të ndryshme gramatikore të cilat kanë dhe një variant gjegjës që nuk kryen ndërrimin fonetik $y \rightarrow i$ në P ose në F1 e F2: emri ST 18 frima shënohet në P 299 frymë; mbiemri prejnumëror i emëruar SM 3 të ditin del pranë P 298 e dyta e F2 XXVII e dytë, mbiemri prejfoljor i emëruar SM 73 i përmbisuri krahas F2 XXXIII përmbysu; folja SM 9 hin bashkë me P 299, 301 hyn, e folja SM 19 mbillur krahas F2 XX mbyllur; ndajfolja SM 18, ST 5, 9 ati pranë F2 XXXVI aty; numërori SM 7, ST 5 di bashkë me P 299 e F2 XV dy.

Nuk është vështirë të kuptohet se idiolekti influencon dialektin; si rrjedhim kufiri ndarës nuk është i prerë. Si shembull mund të sillen emri sy që del në SM 5, kronologjikisht vepra e parë e studiuar, me formën sitë. Në F1 9, Autorja regjistron variantin sytë dhe e konfirmon këtë përzgjedhje fonetike në veprën e dytë, RV, që është vetëm krijim letrar (pa fjalor e pasthënie): khs. RV 84, 87, 99 sytë. Vetëm se fenomeni nuk është i vijueshëm, sepse në tekstin narrativ të ST, vepra e tretë, dalin sërish të dyja format: 6, 141 sitë e 203 sytë. Në F2 trajta e përgjithësuar është sytë (khs. VII sytë te zëri çarçaf). Tjetër shembull luhatjeje është shkrimi i variantit të dyfishtë të leksemës SM 11, 45, ST 82, 268 grikë dhe RV 109 grykë, dhe epërsia e formës mbidialektore grykë në F2 VI. Po kështu nga SM 69 diert, ST 232 diertë kalohet në RV 34 e, më tej, në F2 VII dyertë. Përfshihet në këtë dukuri dhe mbiemri/përemri pronor i vetës së tretë shumë: SM 35, 80 e tire, variant i përgjithësuar, krahas formës tjetër në RV 27 e tyre, 108 të tyre, që del në ST 5, 29 e ture, e vetmja

formë e regjistruar, për t'u ndërruar akoma në F2 XXXVI të tyret. Alternimi fonetik y→u, që AD e jep si karakteristik të së folmes së Gjirokastrës [khs. ature AD, I: 150], këtu nuk është i përgjithësuar. Pra, inkoherenca ndeshet në tekstin narrativ, sepse Kokalari vetë në tekstin informues e argumentues përdor format mbizotëruese në gjuhë, ato që po çonin në hullinë e krijimit të një koineje.

Ndërrimi i zanores së lartë ndodh edhe brenda diftogut -ye- tek folja SM 3 kthie dhe mbiemri prejfoljor SM 50 E shqierë. Folja pyes del vetëm dy herë me variantin SM 43 piet, 19 pietja (sic) krahas formës së përgjithësuar me j: SM 21 pjeta, RV 115 pjesin, ST 7, 27 pjeti, SM 58 pjetur me ndryshim dhe të theksit të fjalës. Nuk mungon dhe trajta jokarakteristike dialektore: RV 78 Pyete, 95 pyeti, që përsëritet në P 299 pyet. Dilet nga ambienti dialektor me format foljore: P 297 thyen, 302 u-thyen. Këmbimi i kundërt fonetik i→y haset tek përemri ai që shënohet vazhdimisht ay në RV 11, 12, 39 dhe në F1 15 e P 299, d.m.th. epërsi e plotë e formës dialektore.

Përdorimi i zanores së mesme të shurdhëtë para bashkëtingëlloreve hundore [AD, I: 136, 137 e 139] është i përgjithësuar tek emrat: SM 3 fëmërat, SM 55, RV 28, ST 32 zëmër, SM 23 vënt, 19 të ënjten, ST 30 e ënjte; te folja: SM 28 u-gjënt, 32 gjëndet; dhe te ndajfolja o parafjala: SM 9, 16, 62, RV 21, 53, ST 5, 6, 13 brënda. Sporadike është ndonjë trajtë emërore me të mesmen e përparme e, si SM 55 zemrën, RV 27, ST 50 zemër. Në të gjitha rastet P ruan ë para hundores: 297, 298 vëndin, 297 zëmrat, 299 të ënjten, po kështu edhe F1 12 e F2 XXXIV vënt. Dialekti është mbizotërues.

Nuk është i rregullt zëvendësimi i zanores qendrore së mesme ë me të mesmen e përparme e [AD, I: 133] te folja lë: SM 3, RV 17, ST 22 Lermë, SM 51, ST 122 lereni, SM 64 ta lemë shkruhet krahas SM 11, 77 kam lënë, SM 6, 30 do të lënë, RV 57 ka lënë, ST 11 t' i lëmë. Fenomeni i kundërt regjistrohet me foljen ngre: RV 40 U ngrë bashkë me ST 9 u-ngre, e me foljen fle: RV 21, ST 151 flë krahas ST 45 do të fleç. P 300 e F2 XII përdorin flë e F2 X kanë lënë. Këtu mund të

trajtohet edhe ndërrimi fonetik te ndajfolja e kohës atëherë: SM 10, RV 11, ST 60 atëhere krahas SM 46, ST 66 atëherë; dhe te përemri i pacaktuar njëra: SM 6, RV 6, ST 43, 75 njëra bashkë me SM 73, RV 67 (vetëm një herë) njëra. Në ST 264 del trajta Njëra që qortohet në errata corrige XLVI me Njera. P 298, 300 ka vetëm njëra.

Këmbimi tingullit zanor të lartë i me të mesmin qendror ë [Totoni: 86] është i rregullt tek emri SM 4, RV 141, ST 45 gjëlpërë. P 300 ruan të njëjtin tingull. Po ashtu edhe fenomeni i kundërt, i përgjithësuar tek leksema SM 5, 75 qindizma, RV 134 të qindisur, ST 57 qindiste, ndërsa për foljen përpjij varianti me i shënohet vetëm një herë në të tria veprat: SM 5 të përpjijë, pra dukuria nuk është emblematike. Luhatje grafike paraqet ndajfolja e kohës gjithnjë: SM 6, 52, 68 gjithënjë e 7, 20, 49 gjithënjë. Në RV 11, 33, ST 7, 50, 82 gjithënjë del e përgjithësuar, si në F1 67, 69, P 297 e F2 III.

Ndeshen njëkohësisht të dyja variantet e foljes dëftej/dëftoj me alternimin e zanores së temës: SM 54 Dëftehej krahas 12 dëfton, RV 74 u dëfteu bashkë me 33 dëfton, 99 u-dëftoi, 136 dëftoi. Në ST del vetëm dëftoj, 68 dëfton, 131 t'u dëftonte. Kokalari zgjedh temën në -o: F2 III dëfton. Tipik dialektor toskë [AD, I: 325] është ndërrimi i zanores së temës e me o te folja them: SM 4, 25, 59, RV 41, ST 13 thom, 27, do t'ju thom, 38 do të thomi, 31 të thom, 39 të thomi, 15 të thom, trajtë e përgjithësuar. Bën përjashtim: SM 66 do t' ja them (që del vetëm një herë), RV 60 them, 113 do të them (dy herë). Në F2 VI, XXV dhe në tekstet e këngëve (ST 75, 169) haset vetëm Them. Autorja nuk e ka në idiolekt.

Ndërrimi i zanores së mesme të përparme e te SM 49 tjetrit, 74 tjetrin, 73 tjetrën, 80 tjetra me të ulëtën a te SM 20 tjatri, ST 31 tjetër, nuk regjistrohet në RV. Kokalari e përdor në F1 71 tjetrën, por është një shembull i izoluar, sepse varianti me e është i përgjithësuar në RV 54, ST 69 tjetra, RV 68, ST 31 tjetri dhe në P 298 tjetra, F2 XXI tjetri. Fenomeni i kundërt, edhe ky i kufizuar, del te emri RV 69 hardhisë, 69 hardhija, që shënohet bashkë me variantin dialektor ST 5 erdhi,

289 e erdhisë. Mbiemri cilësor i prejardhur nga F2 XXII ergjënd shkruhet vetëm me e nistore: ST 31 e ergjëntë.

Këmbimi i ë-së së temës me të lartën u [Ttoni: 85] haset në RV 78, 104 pullumba, 62 ulurinte. Luhatje regjistrohet te trajta e emrit RV 99 kushurinjtë, ST 33 Kushurinj, 33 kushurirat, krahas variantit të përgjithësuar 49 kushërirat. Autorja i ka të dyja variantet: F2 XIV kushërinj e XXXVI kushurinjtë. E paqëndrueshme është grafia e foljes numëroj: RV 95 mos nëmëro, ST 82 nëmëronte, dhe RV 100 Do numuroj, ST 264 numuronte, krahas RV 100 numëronte, ST 67 numërojti.

Jo shpesh ndeshet rënia e zanores pastheksore të lartë -u- në RV 91 kukllat, 111 kuklla, megjithëse dukuria nuk është e përgjithësuar: SM 70 shpatulla, 75 kumbulla, ST 53 vetullat. I përhapur është fenomeni i rënies së zanores së mesme -ë- paratheksore: RV 24 thrimet, 6 dbora, 109 do ta dbojmë, SM 77, RV 11 thret. Emri dërrasë regjistrohet me të njëjtën formë drasa(t) në RV 51, ST 10 dhe në P 297 e F2 X; po kështu fojla ndërroj del në ST 155 Ndroi dhe në P 300 ndrohet, F2 III duke ndruar. Përkundrazi, ruhet e mesmja e pazëshme paratheksore te vëllai, në SM 27, RV 72, ST 186 dhe në F2 XXXVII vëllajt. Nuk bie pastheksorja te emri dhëndëri në RV 141, ST 164 e P 299 dhe te mbiemri (i emëruar) e ngaherëshmja në ST 27 dhe e ngaherëshme në P 300. Ritmi i shpejtë që rrjedhon nga tkurrja e leksemave nuk është tipik e toskërishtes, e cila rëndom e ruan ë-në në të gjitha pozicionet.

Konsonantizmi. Përsa i përket sistemit të bashkëtingëlloreve, një ndër fenomenet fonetike më të përhapura në toskërishte, pra dhe në të folmen e Gjirokastrës, është ai i zëvendësimit të bashkëtingëllores së lëngët polivibrante rr me monovibranten r [AD, I: 90]. Për Totonin, dridhësja rr nuk bën pjesë në sistemin fonetik të së folmes gjirokastrite [Ttoni: 91]. Vërtet ajo humb intensitetin në tekstin narrativ te emrat: SM 3 zorët, 7 vjehra, 25 qura, 28 zjarin, RV 33, ST 18 ëndër, RV 131 furës, 61 kokra, 93 kraba, 103 robot; te mbiemrat:

ST 24 e reme, 5 çjerë (sic); te foljet: SM 32 rëmbien, RV 60 rëmbeu, 76 roj, ST 5 rethojnë; e te ndajfolja RV 95, ST 8 kurë, dhe në idiolekt te emrat: F1 7 vjehrat, P 297 rënjë, rezet, 299 barë, ferë, 300 ëndra, F2 XXVI të rënqethur, te mbiemri F2 XV i rumbullaktë; te foljet: P 297 rjedh, 299 ruhet; e te ndajfolja F2 IV rallë. Por kjo s'do të thotë se dridhësja intensive nuk haset. Me të dyja variantet shkruhen emrat rrëzë, përrallë e burrë: SM 16, RV 103 rëzë krahas SM 8 rrëzave, 57 rrëzë; RV 17 prallat, 36 pralla bashkë me 6, 38 prrallën; RV 37, ST 15 bura, 7 burave krahas SM 14 burrin, RV 36, ST 186 burrat. Zëri rrëzë del vetëm me monovibrante në RV e ST dhe ruhet i tillë në P 298 rëzë e në F2 XV rëza. SM ka vetëm burrë me polivibrante e, me gjithë luhatjet në RV e ST, Kokalari e përdor: F1 44, P 298 burrë, F2 VI burrit. Pra nuk është një zgjedhje e vijueshme.

Lëkunden trajtat e foljeve marr, harroj e rri: SM 3, RV 12 mer, RV 21, 44 marin, SM 43 do të marë, 11 pa marë bashkë me variantet: SM 3, 11 merr, 5 do të marrë, RV 130 të marrim, 72 t'i marrim; SM 31, ST 24 haron, RV 37 harove krahas trajtave: SM 22 harroi, 57 u-harrove, RV 141 harroj; SM 10, RV 5 rinë, 32 ri, 56 të rimë, ST 45 rinte krahas RV 18 rrinte, 50 Rrinin, 70, 71 Rri. Ndajfolja e parafjala rreth regjistrohet në SM 7, RV 39, ST 86 reth por edhe SM 40, RV 62 rreth. Ndërsa në SM e RV përdoren të dyja variantet, në ST mungon forma me polivibrante. Në të kundërt, grafia me dridhësen intensive rreth do të jetë e vetmja në P 297 e F2 XII. Në kopertinën e pasme në RV shënohet titulli Reth vatrës, por në kopertinën e pasme të ST, ky titull është korrigjuar me Rreth vatrës. Orientimi i Autores është i qartë, megjithëse nuk mungon ndonjë rast jokoherent në idiolektin e saj: P 302 të rojë bashkë me 302 rron; P 302 mer krahas 299 të marrin; F2 XII ri e X rri, XI kurë pranë XIII kurrë.

Teksti narrativ ruan anësoren I në vend të shtegores qiellzore j [AD, I: 196] tek emrat e parmë: SM 8 falin, 7 fëmilë, 3, 35, ST 9 malë, SM 5 pala, 24 shilën, 12 murtala, ST 104 valin. Luhatje paraqet emri gojë, që regjistrohet në SM 9, 31, ST 14, 18, 21 golë, bashkë me F1

35 e 80 gojë, e më tej P 300, F2 XXXIII gojën. Me një përjashtim të RV 19 gola, zërat dalin me qiellzoren mbidialektore në RV: 132 vajin, 38 fëmijë. Ky është dhe varianti i Kokalarit në F2 XXI fëmijë, P 298 maja, F2 X majë, P 300 paja, F2 XVI pajë. Dukuria haset dhe te numërori ST 7 një milë që shkruhet i palatalizuar në P 298 një mijë. Megjithëse është një fenomen morfofonologjik, mund të radhisin në këtë grup emrat e prejardhur me prapashtesën -lë (-je): ST 19 sëmundlën, 43 plasëlë, 292 vdekëlat. Ndeshet një rast i vetëm ku anësorja grykore ll i korrespondon një shtegoreje qiellzore j: ST 44, 157, 191 rëmullë, formë e përgjithësuar në ST, krahas F1 53 rëmujë [Çabej VI: 326]. Edhe një herë Autorja shënon formën që përceptohet si mbidialektore.

Mëdyshja në përdorimin e anësore alveolare l në SM 7, ST 7 avlija, SM 62, ST 24 mëhaleja, SM 11 mëhalesë, ose të grykores ll në SM 11 avllinë, 53 mëhalla, 76 mëhallë tregon se diktohet nga idiolekti.

Fenomenet fonetike të alternimit të bashkëtingëlloreve mbylltore/shtegore nuk janë fort të përhapura. Bashkëtingëllorja mbylltore dybuzore e shurdhët p zëvendëson shtegoren buzodhëmbore gjegjëse f në leksemën kapshatë në SM 77, por SM 12 regjistron në mënyrë inkohërente kafshatën. Këmbimi bëhet rregullisht në ST: 19, 278 kapshata. Vetë Kokalari nuk e përdor këtë variant: në F2 XI del të kafshuar dhe kafshoi. I njëjti tingull mbylltor p i temës në RV 6, 70 kopshtit, që është e vetmja formë e shënuar në RV, bjerret në ST: 5, 289 kosht, 202 koshtit, formë e përgjithësuar.

Shtegorja buzodhëmbore e zëshme v zëvendëson dybuzoren b në ST 133 e çorvës. Po kështu ndërrimi b→v në SM 10 torvën e në RV 69, ST 48 torvë është i vijueshëm. Por Autorja, që në F1 43 ka torbën, në mënyrë inkohërente në P 297 shkruan prapë torvë. Luhatje në idiolektin e Kokalarit, dhe jo në tekstin narrativ, haset te leksema vrimë: RV 35, 106 vrimë, ST 12 vrima, formë e përgjithësuar, krahas F2 VIII brima e XX vrimë.

Ndërrimi i shtegores ndërdhëmbore dh me mbylltoren dhëmbore d del te leksema çardhakut në SM 3. Dukuria është përgjithësuar me zërin perde në ST: 23 perdhe, 291 perdhen. Variantin perdhe e ka Kokalari në P 299. Ndërkohë, në veprën kronologjike në mes, RV, shkruhet vetëm trajta me dhëmbore: 65 perden, 133 perdet.

I veçantë paraqitet përdorimi i afrikateve. Është fare pak i përhapur fenomeni fonetik i ndërrimit të afrikates së shurdhët postalveolare ç me shtegoren gjegjëse sh, si te SM 60 çilte, ST 14 çiltenë. Leotti e ka shilte. I vijueshëm është zëvendësimi i afrikates së shurdhët ç me të zëshmen xh në SM e ST: SM 44, ST 265 xhurape, 5 xhurapet. Dukuria nuk haset në RV, ku shënohet 84 çarape. Në F2 VII, XIX e XXIV del gjithnjë çarape. Edhe këtu trajta dialektore është e kërkuar. Leksema emërore me funksion ndajfoljor çurg ‘curril’ regjistrohet Xhur (lotët) në SM 51, ST 12, pra e bjerr tingullin bashkëtingëllor fundor. Nuk mungon dhe zëri me afrikate të pandryshuar: RV 109 Çur çur (lotët). Edhe një herë konfirmohet ideja e mosrealizimit të këtij fenomeni fonetik në veprën letrare të ndërmjetme, RV.

Për alternim afrikatesh alveolare, e shurdhëta c me të zëshmen x, bëhet fjalë te folja kërcej që del kërxiër në SM 43. RV e ST e kanë vetëm me c: RV 76 kërceu, ST 12 kërcente. Po kështu për foljen kapërcej, që shkruhet kapërxiër në SM 68, grafia me të shurdhëtën në RV e ST është e përgjithësuar: RV 72 Kapërcyen, 13 do ta kapërcejmë, ST 186 kapërceu, 111 kapërce. Kësaj radhe është Kokalari vetë që lëkundet: P 298 i kapërcimit, 300 kapërcen por edhe 302 për të kapërxyer (formë e vetme), si SM. Fenomeni fonetik nuk është i rregullt e karakterizues.

Sporadik është rasti i emrit llucë që regjistrohet në RV 138 lluçë. Mëdyshje paraqet leksema mace: trajta e përgjithësuar në SM 27, ST 6, 9, 276 maça, ST 42 maçe, del në RV vetëm me variantin 27 macen, 133 macja. Kronologjike fenomeni nuk verifikohet vetëm në RV. Trajta me afrikate alveolare përzgjidhet në F2 XV e maces.

Një ndërrim marginal e jokarakteristik për dialektin gjirokastrit [AD, II: 149] është zëvendësimi i shtegores s me afrikaten c: RV 71,

78 laraska, 77 e laraskës dhe RV 71, 85 larackë. Duket qartë se për ndërrimet fonetike të afrikateve, RV paraqet tekstin narrativ më afër së folmes mbidialektore.

Tjetër dukuri fonetike e gjithmbarshme në toskërishte është shurdhimi i tingullit bashkëtingëllor fundor [AD, I: 112]. Vëzhgimi i tij i kujdesshëm tregon se ndërrimi i tingujve në veprat e Kokalarit bëhet edhe në prani të morfemave trajtëformuese e/o fjalëformuese. Shurdhimi i bashkëtingëllores mbylltore grykore të zëshme g ndeshet kryesisht te emrat. Del me mbylltore të shurdhët emri prag: SM 34, ST 5, 104 praku, RV 106 prak, 111 prakut. Në P 300, pra jashtë tekstit narrativ, shënohet trajta Pragu. Me dy variante regjistohet emri zog: ST 115, 257 zog, formë mbizotëruese, dhe RV 47, 133 zog, e vetmja formë e regjistruar. Trajta e mbiemrit të prejardhur nga emri dhogë me prapashtesën -të këmben tingullin mbylltor g→k: F2 XXIII e dhoktë. Folja djeg del SM 16 djektë (dëshirore) krahas SM 68 djegtë. Kokalari në F2 XXI ka djeg. Fenomeni haset te kategoria e ndajfoljes: ndajfolja e vendit ST 59, 203 lark, vërejtur vetëm një herë, shënohet bashkë me 98 larg, që përfaqëson idiolektin e Autores: P 300 larg. Ndajfolja e mënyrës shkruhet vetëm me të shurdhëtën: SM 34, 54, ST 215 liksht.

Alternimi i tingullit shtegor alveolar të zëshëm z me gjegjësën e shurdhët s vërehet te emrat: SM 57, ST 201 bres krahas RV 81 brezi, ST 195 brezin; ST 5 kafase dhe 217 kafazeve; ST 32 gas dhe 276 gaz, 22 gazi. Lëkundet teksti informues: F2 X bres bashkë me XIII brez, XIX kafas dhe XIII gazi. Kjo gjë tregon se shurdhimi fundor nuk ka të bëjë gjithmonë me pashquarsinë. Fenomeni i kundërt i sonorizimit të tingullit fundor shtegor del te zëri mëngjes, formë e përgjithësuar në gjuhë shqipe: SM 11, 70, RV 8, 71, ST 5, 30 mëngjes, RV 71, ST 69 mëngjesit bashkë me SM 74, ST 151 e mëngjezit, RV 31 mëngjez. Kokalari nuk e ka: P 298, F2 XXIII mëngjes. Për leksema në shumës me morfemën në zanore mund të citohet ST 161 qiparis pranë 10 qiparizet. Domethënës është shurdhimi te shumësi i parregullt i

emrit njeri: SM 70, 238 njerës bashkë me SM 67, RV 73, ST 12 njerëz. Edhe një herë Autorja është në mëdyshje: F2 XX njerës pranë F1 51 njerëzit, F2 XXIV njerëz. Nuk ndeshen format e pashquara të fjalëve pus e qeros, por ato të shquarat regjistrohen vetëm me tingullin e zëshëm: ST 5, 45 puzi, 271 e puzit, dhe RV 133, 138 Qerozi. E zëshme është nistorja e leksemës sorkadhe: ST 14 zorkadhe. Rregulla fonetike mbidialektore akoma nuk është stabilizuar.

Ndër çiftet e tjera shtegore këmbehen shpesh ndërthemboret dh→th, në pozicion fundor. Kjo ndodh te kategoria e mbiemrit: SM 21, RV 32, ST 18, 32 (i, e) math së bashku me SM 60, RV 72, ST 50 (i, e) madh. Autorja nuk e shurdhon tingullin e zëshëm në P 297, F2 VI, XV (i, të) madh. Tek emri asnjans prejmbiemëror shkruhen të dyja variantet vetëm në ST 233, 287 me të math krahas 150, 153 me të madh. Grafia me të madh është mbizotëruese në RV 47, 89 e në F2 XIX, XXVIII. Format e tjera të emëruara të shquara dalin me të zëshmen: SM 3, ST 148 i madhi, SM 68 të madhin, RV 72 të madhit.

Fenomeni është më i përhapur te foljet kryesisht në pozicion fundor dhe, më rrallë, përkrah morfemave trajtëformuese, vetëm në SM: 21 heth, 46 u-hoth, 30 mbleth, 58 rrjeth, 36 rrjethtë krahas formave me të zëshme: 45 u-hodh, 28 hedh, 29 do të mbledhç. RV e ST nuk e regjistrojnë sepse leksemat e kësaj tipologjie (me -dh fundore) i nënshtrohen një ndërrimi tjetër fonetik: shtegorja dh zëvendësohet nga anësorja ll [AD, I: 91]: RV 26 holle ‘hodhe’, ST 68 hollli, 63 hillnin, 64 hill, RV 89 të shurllonin, që nuk realizohet në SM. Nuk mungon dhe grafia me shtegore në RV 83 hodhi e ST 22 hidhte, sepse forma është përgjithësuar, si e shënon dhe P 300, F2 VIII hedh, P 299, F2 XIII hidhet (nuk haset e pakryera). Këtu shtohet edhe mbiemri të drellura në ST 160 (rast i vetëm) bashkë me 155 të dredhura, trajtë e stabilizuar. Kjo dukuri duhet të ketë qenë parësore në krahasim me shurdhimin dh→th, se nuk ka raste të alternimit th→ll.

Sporadik është ndonjë shembull emëror, si ST 61 llogë krahas 271 dhoga e ST 12, 13 perilletë ‘perdet’ bashkë me 12, 13 perdhëtë. Nëse në rastin e parë, leksema dhogë është italianizëm ‘doga’ i ndërmjetësuar në shqipe nga gr. e re ‘δὸγα’ [Meyer: 87], pra tingulli nistor është burimor; në rastin e dytë, huazimi turk perde nga ‘perde’ [Dizdari] këmben mbylltoeren dhëmbore d me shtegoren ndërthëmbore dh brenda gjuhës shqipe dhe, vetëm pas përfundimit së këtij fenomeni fonetik, ndërrohet akoma në anësore grykore ll. Në RV, vepra në mes, del vetëm 65 perden, 133 perdet, por Kokalari përdor vetëm perdhe në P 299. Në këtë grup radhitet folja ndez e mbiemri prejfoljor i,e ndezur: ST 62 qe llezur, 103 e llezur krahas ST 6 dhez, 100 e dhezur. Trajta dhez, e të njëjtit burim i.e. me ndez, është forma “e vjetër e primare e fjalës”, mbizotëruese “në dialektet anësore të truallit shqiptar” [Çabej IV: 30] krahasuar me ndez, që pati epërsi në shqipe. Pra, leksema ndez perceptohet si një trajtë më moderne. Ndërrimi fonetik është i kufizuar vetëm në ST. SM (73 u-ndez) e RV (72 ndezim, ndezën) nuk e kanë. Autorja shënon vetëm trajtën ndez: P 299 të ndezura, F2 XXIV e ndezur. Domethënës në F2 XI është shpjegimi i leksemës dhez me variantin ndez.

Këmbimi i kundërt ll→dh është i pranishëm në foljen mbyll: ST 22, 276 mbidhte, 23 mbidhi, dhe në mbiemrin prejfoljor gjegjës: ST 20 të mbidhur. Khs. dhe ST 21 të mbadhoste, fjalë e tekstit narrativ që regjistrohet për t’u shpjeguar në F2 XXV, sigurisht pa dashje, me variantin ll: “Mballos (greq): arnoj”. Statistikisht është zhvillim fonetik me kah të kundërt krahasuar me të folmen gjirokastrite.

Grupi bashkëtingëllor fundor -nd del në kategorinë e emrit, në trajtën e shquar: SM 7 vëndi, RV 65 vëndin dhe në numrin shumë: SM 23, ST 11, 19 vënde. Shurdhimi i dhëmbores në formën e pashquar, si në SM 23, ST 6 vënt, nuk është përgjithësuar, khs. SM 26, RV 15 vënd. Vetë Kokalari i përdor të dyja: F1 12 vënt e F2 XX vënd. Po kështu, SM 80, ST 11 funt bashkë me SM 68 (e) fundit, ST 12 fundi, siç duket qartë kur të dyja format regjistrohen

në të njëjtin togfjalësh: SM 15 në funt të fundit. Autorja ka vetëm F2 IV, VIII, XI fund. Fenomeni i shurdhimit ndodh në kartegorinë e foljes. Regjistrohet vetëm pozicion fundor absolut: SM 28, ST 22 u-gjënt; janë sonore format e tjera me mbaresë: SM 32 gjëndet, ST 156 gjënden, a me prapashtesë: SM 23 gjëndur. Të dyja variantet dalin te folja servile ST 263 munt e F2 XXVII mund, kjo e fundit është e idiolektit. Numërorët përgjithësisht e shurdhojnë dhëmboren e grupit në pozicion fundor absolut: SM 8 njëqint, 19 pesëqint, ST 7 diqint, 18 një qint. Ndeshen dy grafitë në SM 19, ST 156 nëntë e në RV 75, ST 56 nëndë. Në errata corrige në ST zëri nëndë (69) qortohet me formën nëntë (XLIV). Kokalari shënon nëntë në F2 XXVI. Këtu shtohet edhe ndajfolja sonde në RV 38 e sonde në ST 13, 104 e në tekstet e këngëve.

Qiellzorëzimi gj i grupit gl- [AD, I, 191], karakteristik toskë, vërehet tek emri gisht: RV 53, ST 18 gjisht, RV 19 gjishtin. Trajta ST 111 gisht qortohet me gjisht në errata corrige (XLV). F2 luhartet: regjistron në IV, XIII gjisht dhe në VIII: “gjashtë gishtre mëndafsh e katër gjishtre li”. Citimi “Një gisht firë” në F2 XIII, marrë nga ST 35, është i gabuar, sepse teksti narrativ ka: një gjisht firë. Pra, mëdyshjet e realizimit të fjalës janë të Autores, jo të formës që përdorej rëndom.

Grupi -lk- në temën e fjalës nuk palatalizohet në -jk-: ST 27 ulkut, 49 ulku.

Dukuria e zhvillimit të tingullit homorganik -b- pas hundores dybuzore m te mbiemri i madh: RV 9, ST 79 e mbëdha, 157 të mbëdhenj, nuk është i pranishëm në veprën e parë, SM (15 të mëdhenj). Të dyja format shkruhen vetëm në RV (khs. 92, 104 e mëdhenj), ndërsa ST ka gjithmonë tingullin e shtuar. Vetë Kokalari ndjek grafinë mbidialektore të SM-së: P 297 e mëdha, 298 të mëdhenjtë. Konfirmon rregullën e RV-së, grafia e zërit 87 shtama, 88 shtamë krahas 85 shtamba.

Epentezën e një hundoreje e gjejmë në RV 25, ST 52 cingar për cigare. E ka dhe F2 XXVII cingar.

Bashkëtingëllorja shtegore faringale h del me epentezë te përemri vetvetor vete: SM 5, RV 35, ST 16, 19, 57 vehte dhe përdoret edhe nga Kokalari në F1 55 vehte, F2 XIV, vehten. Duhet thënë se në ST është po aq e përhapur edhe trajta pa epentezë: 6, 44, 191 vete. Nuk është e përgjithësuar prosteza e shtegores te folja arrij: RV 73 harritën, ST 52 hariti, e te emri F2 X hunazën. AD e jep “të rrëgjuar” [AD, I: 183] shqiptimin e shtegores faringale te folja shoh në të folmen gjirokastrite. Bjerrja e tingullit del në RV 26 Shi e në ST 14, 21, 26 she në pozicion fundor, por ndeshet dhe përkrah morfemës trajtëformuese (të vetës): ST 31, 189, 282 Shinin. Fenomeni nuk haset në SM (4, 14 sheh, 6 shihnim). Nuk mungojnë dhe format e plota në RV 40, 86 sheh, 67 shihni e në ST 160 shihnin. P 299 e F2 III kanë sheh: ky variant është mbizotërues.

Emri ahur është regjistruar vetëm me formën me metatezë: SM 7, ST 62 haur, RV 33 hauret, ST 28 haurit. Kështu mund të interpretohet trajta e ndajfoljes së vendit gjekët në SM 12, RV 40, ST 18, krahas formës mbizotëruese në toskërishte gjekë [Çabej II: 22, IV: 324].

Së fundi, qoftë në tekstin narrativ qoftë në atë informues e argumentues ndeshen disa veçori fonetike, edhe pse jo të qenësishme, që dalin nga kuadri dialektor toskë. Përsa i përket vokalizmit, dihet se hundoret nuk ekzistojnë në toskërishte [AD, I: 88]. Dallimi themelor dhe i përgjithësuar i dy dialekteve kryesore, gegë e toskë, është prania e zanores a hundore të gegërishtes, së cilës i korrespondon e mesmja ë në toskërishte. Emri trëndafil (me ë etimologjike) i toskërishtes del Trandafilet në ST 15 e disa herë te këngët, e përdoret nga Kokalari: F2 XVI e trandafiles. Dhe leksema ëndje regjistrohet në SM 24, ST 15 Ta k’ anda. Folja ënjt del F2 XIX qenë ajtur; mbiemri prejfoljor i ënjtur shënohet nga Autorja me trajtën pa nazalizim: F1 29 e ëjtur krahas trajtën me hundore: F2 XIV të ajtura. Folja ha paraqet tingullin a të formës përfaqësuese: SM 11 hangre, ST 21 hangri. Forma është përgjithësuar në F2:

XXXII hangri. Po kështu edhe folja (j)ap në ST 271 Nam (një çikë) për nëm ‘jepmë’, “urdhërore sekundare ndaj amë e ëmë/ëm” [Çabej II: 55].

Tjetër fenomen tipik gegë është ndërrimi i zanores ë në i te nyja joshquese: SM 61, 72, ST 5, 18 një në krahasim me formën e përgjithësuar një në SM, RV e ST. Në RV një nuk del.

Këmbimi i zanores së lartë i me y, dukuri tipike e gegërishtes [AD, I: 147] ndeshet në RV: 112 bylbil, 136 rryp, 140 rrypin, që konfirmon statusin e RV më afër një forme gjuhësore mbidialektore.

Fenomeni i rotacizmit [AD, I: 197] nuk respektohet nga Kokalari në shkrimin e emrit të qytetit Gjirokastër (khs. F2 VIII) që shënohet edhe me formën gege Gjinokastër (khs. F2 III, X, XX, XXXVII), pra zëvendësim i ndërgjegjshëm. Po kështu në F1 57 të tëhullunit (nga folja tëholl).

Reduktimi i grupit bashkëtingëllor mb→m regjistrohet në ST për foljen tremb: ST 272 tremte, 277 trëmtë, dhe foljen dhemb: RV 5, ST 80 dhimte, 261 u-dhimnin. Dukuria nuk verifikohet në RV për foljen tremb (59, 107 u-tremb) dhe nuk i përket idiolektit të Autores: P 299 trëmbin, F2 XXVIII trembet; XXIII, XXXIX dhëmb. Ndërsa reduktimi i grupit nd→n te mbiemri i pakufishëm (sepse shoqëron një emër) nonjë në ST 45 për ndonjë, duhet interpretuar si gabim shtypi, nuk mund të jetë e tillë leksema: (për) kryeshënoshë, që del në F1 64 në vend të kryeshëndoshë. Ndajfolja ngadalë në SM 47, RV 34, ST 16, formë e vijueshme, shënohet krahas kadalë në SM 16, ST 22, tipike e gegërishtes.

Shembulli i fundit që e projekton menjëherë idiolektin drejt një forme mbidialektore janë variantet lidhëzore me dy sibilante -ss-, sipas traditës së konsoliduar grafike që fillon me Bardhin [Çabej VI: 148], F2 XXVII mbassi, e gegërishtes dhe XXXI passi, e toskërishtes.

Leksiku. Aspekti tjetër që i bën pa dyshim të vyera veprat e Kokalarit është pasuria e rrallë leksikore. Që në titullin e veprës Siç më thotë nënua plakë ndeshet një përdorim i veçantë i emrave të

farefisnisë, saqë Lambertzi, i lëkundur, e përkthen në dy mënyra togfjalëshin nënua plakë: alte Mutter ‘nënë e vjetër’ [Lambertzi1 II: 267] e alte Grossmutter ‘gjyshe e vjetër’ [Lambertzi2: 85]. AD për Gjirokastrën jep gjyshe (sic) ‘nëna e babait’ [AD, II: 234]. Në tekstin narrativ togfjalëshi shkruhet ndaras e njësh, për të treguar kohezionin e nocionit të shprehur: RV 27 nënua plakë, 49 nënua-plakë, derisa sa e redukton ndajshtimin: RV 25, ST 24 nënua, RV 38 nënon, 88 e nënos, pra është leksemë e mjaftueshme për të treguar gjyshen. Morfema fundore -o e dallon qartë nga nëna ‘mamaja’: SM 23, RV 18, ST 6 nëna. Haset dhe zëri sinonimik: SM 21 nën-dajkua, RV 51 Nën-dajko, 56 Nëndajkua ‘nëna e nënës’ [ibid.: 238]. Gjyshja ndërkohë është dhe zonja e shtëpisë, në ST 136, 273 e madhja e në P 301 e madhja e shtëpisë; për nuset është SM 57, ST 198 katënxhika ‘vjehrra’. Të rejat që hyjnë në shtëpinë e burrit, më shumë se një emër, kanë një rol. Quhen: RV 16 nuse-madhe, 26 Nuse madhe ose RV 66 Nuse-vogël; mungojnë format e shquara.

Për nipër e mbesa, gjyshi është RV 25, 36 baba-madhi, ST 24 baba-madh dhe pa vizë lidhëse: 206 e babamadh. AD për Gjirokastrën jep gjish (sic) ‘babai i babait’ [ibid.: 236]. Nusja i nderon burrat e shtëpisë duke përdorur fjalën ST 276 çelo para emrit të përveçëm. Gruaja vetë burrin nuk e thërret: SM 25 erdhi ki ‘burri’, 65 i thashë dhe këtij ‘burrit’. Familjarët e tjerë janë: SM 14 vëllesha ‘e shoqja e vëllait’; SM 65, ST 9 xhiko, 49 xhikua e madhe, 232 Xhikua e re ‘motra e burrit për nusen’; SM 22 xhaxhesha e RV 68, ST 135 teto ‘gruaja e xhaxhait’; SM 36 Kanakar e RV 90 kanakaren ‘djalë a vajzë e vetme, e përkëdhelur’; ST 275 motërmaja ‘shoqja e ngushtë’. Si të familjes janë: ST 25 krushqarja ‘shkuesja’, që del me të njëjtën formë në P 298, dhe SM 6 bulla ‘gruaja që shoqëron nusen te burri’, që regjistrohët edhe në P 300. Vlerësime për zonjën e shtëpisë janë ST 5 Nikoqirja e SM 43, RV 42 kapetane ‘grua e fortë’. Por cilësimet për femrat janë të shumëllojshme, nga ndjenja e keqardhjes për fatkeqësitë e kaluara deri te përçmimi e sharja: SM 78 buzë-plasur, ST 61 korba,

27 dit-shkurtër, 7 fatpadala, 26 golë-shtrëmbëta, SM 20 golëhapët, 11 qelbashe, morrashe, ST 29 zëmër-ngushtat, 235 bina-dala, SM 32 gomarja, 26 bushtër. Më i rrallë është përdorimi i figurshëm: ST 264 Si (sic) pëlqeu hanëmes. d.m.th. ‘asaj që mbahej si zonjë’ ose SM 7 zonjë-mëdha ‘ato që e mbajnë veten si të tilla, kur janë shtatzënë’. Për meshkujt sharjet janë të kursyera: SM 9 zabërhan ‘rrugaç’, 62 Shtëpi-prishur, 75 Burrë-ziu ‘jo i mirë’, ST 129 turi der ... Ogursuz. Duket qartë se gjithë këta apelativë krijojnë mjedisin gjirokastrit. Leksiku është vjelë gjerësisht prej tij.

Ndër leksemat tipike popullore të tekstit narrativ, që do të zëvendësohen më vonë në gjuhë nga lentime të reja, mund të përmendet latinizmi gaz: RV 125 Astrit gazi ‘gëzimi që i jep ai’, ST 20 për gaze ‘gëzime, ngjarje të shënuara’. Kryesisht popullor është përdorimi i greqizmit komb: ST 28 një komb ujë ‘një pikë’ dhe 272 Një komb ... në griqë ‘një shtrëngim’. Po kështu, emrat kolektivë në vend të shumësit: ST 12 Burërija ‘burrat’, 24 graria, 202 Djelmuria. Janë sinonimike: ST 28, 75 njerëzia dhe SM 6, 16 bota ‘njerëzit’. Kjo e fundit ndeshet me të njëjtin kuptim në P 300 (botës).

Ndonjë leksemë shpreh kuptimin origjinar, sot përgjithësisht i humbur. Kjo ndodh me fjalën jeta që del që në titullin e veprës ...sa u-tunt jeta (dhe në tekstin narrativ: ST 293) me kuptimin ‘toka’. Më parë e ka shënuar De Rada te Këngët e Milosaos: Lis jeta kishë ndërruar. Në idiolekt Kokalari ka ‘jetë’ me kuptimin modern ‘ekzistencë; jetesë’ (khs. P 301 e F2 XXXIX). Një sqarim të shkurtër meriton titulli në ST, që fillon me të vogël: ...sa u-tunt jeta. Nuk është gabim shtypi. Kur «Revista letrare» [Tiranë, 14-2-1944: 7] lajmëron daljen së shpejti në qarkullim të librit, titulli i regjistruar është Dasma, vetëm më vonë, Autorja e ka ndryshuar atë, duke lënë edhe shkronjën e vogël nistore (...sa). Po kështu, leksema qelq del me kuptimin e hershëm gotë: RV 57 Qelqin, ST 15 qelq me ujë, ose përdoret si mbiemër cilësor ‘(mot) i kthjellët’: ST 9 U-bë qelq, 10 grika e Tepelenës, qelq.

Teksti informues i shpjegon krahinorizmat e huazimet lokale me leksema mbidialektore. Janë të gjuhës së folur përcaktimet e harqeve kohore konvencionale, si emërtimet e muajve. Shënohet nga tradita bizantine: ST 58 të shëmitrit për F2 XXXIII tetor; ST 37 të allonarit për F2 III korrik; dhe nga ajo arabe: ST 97 zelikade shpjeguar në F2 XXXIX ‘një nga muajtë e vjetit arab’. Dialektor është emërtimi i ditëve: SM 28 Njënatcaj (sic) për F1 28 parmbremë, SM 70, ST 49 Një ditëzaj për F2 X pardje, dhe i orëve të saj: ST 46, 69 Në nëndë të ditës për F2 XXVI ora tri mbas dreke. Këtu shtohet dhe koha e ngrënies: SM 70 bukë-darka, 77 bukë-drekën, RV 99 bukë darkën (ndaras).

Për kategorinë e mbiemrit vlen të përmenden mbiemrat e prejardhur me prapashtesat -të: ST 19 të dhoktë, 32 të xhevahirtë, 66 të kallamboqtë, dhe -or(e): 264 beharore, të cilët zëvendësojnë emrat nga janë formuar. I veçantë është cilësi ST 14 grumbullore, që shpjegohet në F2 XV e rrumbullaktë. Mbiemri i bardhë përdoret në tekstin narrativ kryesisht me kuptim karakteristik të ngjyrës, por edhe me atë të figurshëm ‘i lumtur, fatmirë’: SM 24 ditë të bardhë, ST 15 derë-bardhë. Emrat shkumë e zborë ‘dëborë’, kur e shoqërojnë, marrin kuptimin ndajfoljor ‘shumë’ dhe formojnë shkallën sipërore absolute: ST 195 e bardhë shkumë, 270 e bardha zborë. Mbiemri i zi del me kuptimin e figurshëm ‘i shkretë’: SM 45, 55 nëna e zezë, ST 24 Ajo e zezë, 48 fukaraja e zezë. Kur mbiemri shoqërohet nga emri pisë, ky i fundit ka kuptimin ndajfoljor ‘shumë’: SM 72 pisë i zi, ST 47 (leshtrat) e zeza pisë. Kuptim të figurshëm kanë dhe mbiemra të tjerë: SM 34 kunata e ngarkuar ‘shtatzënë’, ST 234 si të qepura ‘të mbyllur (nga gjumi)’, SM 11, ST 267 derë e parë ‘familje e mirë’, ST 7 koll’ e ligë ‘tuberkuloz’, 30 odan’ e mirë ‘dhoma e pritjes’.

Janë karakteristike dialektore foljet: ST 15 e pikëllon ‘i hedh yndyrë’, SM 40 qe goditur, ST 45 është goditur ‘ujdisur (për gatesën)’, ST 277 kish kulluar ‘dobësuar’, SM 28, RV 31, ST 11 kreu ‘nxori’, ST 8 na ndërto një filxhan kafe, 8 ndërtoi kafënë ‘bëri kafënë’, SM

5, 23 Ngreje nga mëndja 'hiqe', ST 61 ta lips 'ta dëboj'. Folja qëroj regjistrohët me kuptimin 'hap': ST 280 Grika e Tepelenës u-qërua, 9 Qielli u-qërua. Foljet gëzoj e qeveris i përdor dhe Kokalari me të njëjtin kuptim të tekstit narrativ: RV 56 I gëzoi leshrat, 112 i gëzoi flokët dhe P 301 ta gëzojë 'ta përkëdhelë, ta ledhatojë'; ST 7 dhe P 298 për të qeverisur 'për t'u kujdesur'. Folja vij, sipas kontekstit, tregon afrim të folësi: RV 15 erdhi përposh 'zbriti, i shkoi pranë', ose mbërritje në një vend larg folësit: RV 13 Kur erdhi tek dera, 13 Vjen edhe djali, ST 33 Erdhën 'shkuan, arritën atje'.

Për kategorinë e ndajfoljes mund të përmendet keq, në ST 27 Duhën keq, që del me kuptimin 'shumë'. Leksikalizim i pasthirrmës hë ndeshet në shprehjen ST 20 hë për hë, që përdoret me kuptim ndajfoljor 'tani për tani', ose në RV 100 hëni shpejt se erdha me kuptim foljor: 'lëvizni'.

Ndryshimi thelbësor tipologjik i tekstit narrativ me testin informues e argumentues e bën pothuajse të pamundur krahasimin leksikor, sepse funksioni i njëjësive leksikore nuk është i njëjtë. Megjithatë mund të vërehet si Kokalari në tekstin informues largohet nga gjuha e folur: ST 14 surat, fjalë e përgjithësuar në tekstin narrativ, regjistrohët fytyrën në F2 III; ST 156 llastikën shpjegohët me huazimin frëng biberon në F2 XXIV. Gjinia asnjëse e tekstit narrativ ST 10 të rit nuk përdoret nga Kokalari dhe shpjegohët me emrin kolektiv rininë në F2 XVII. Mbidialektor është shpjegimi huazimit turk ST 197 okllai me Petës, tërhollës (sic) në F2 XXVII. Ndonjëherë vetë Autorja ka vështirësi të përshkruajë, p.sh. shtrojën ose rrasat prej guri të hajateve, që i përkufizon F2 X me drasa prej guri, pra dhe dërrasë dhe gur, materiale që e përjashtojnë njëri-tjetrin (o dërrasë o gur). Në perceptimin e saj dërrasa kishte formë shtresore (pavarësisht lëndës përbërëse).

Fenomeni është më i dukshëm te huazimet. Lambertzi [Lambertz2: 103-7] përmend huazimet e shumta greke e turke në studimin e tij e, aty-këtu, ato italiane. Italishtja nuk ka ndikuar ndjeshëm të folmen

gjirokastrite. Shumë nga italianizmat, përgjithësisht të hershme, që dalin në tekstin narrativ të Kokalarit, janë regjistruar më parë nëpër fjalorë, artikuj revistash, vepra letrare, etj. [khs. Dashi] e në shumicën e rasteve kanë plotësuar mungesa leksikore të shqipes. Janë emërtime bimësh: ST 9 patate ‘patata’, 15 manxuranë ‘maggiorana’, 31 rizin ‘riso’; pijesh: SM 47 kafe ‘caffè’; sendesh të jetës së përditshme: ST 19, 155 bocë ‘bozza’ (venec.), 110 magje ‘madia’, RV 26, ST 20 kartë ‘carta (lettera)’, 8 i kartrave ‘carte (da gioco)’, RV 131 stivë ‘stiva’ (venec.), ST 264 mostër ‘mostra’; petkash: SM 47, RV 134 fanellën, ST 5 fanella ‘fanela’ (venec.), 49 copë ‘zopa’ (venec.), RV 114 pecetë ‘pezzetto’, ST 94 cipun ‘zipon’ (venec.); njësisish monetare (përdorur edhe për stoli): RV 118 lirat ‘lira’, ST 126 frangë, 263 franga ‘franco’, 137 kollonata ‘colonnato’, 204 ergjënd ‘argento’ [Çabej II: formë e rindërtuar nga latinizmi rgjand]; instrumentesh muzikore: ST 206 gërnetën ‘cornetta’, e aktivitetesh të tjera: SM 34 magji (fig.) ‘magia’, ST 109 muzika ‘musica’ 11 ta paguaje ‘pagare’. Mënyra veshjes: ST 41 allafrënga (qepur), dhe e interpretimit të orës: 209 allaturka (sahati di i natës), kanë si element të parë alla- nga it. ‘alla’ nëpërmjet turq. ala. Interesant është lentimi i ri nga joli a dhjoli ‘violino’, huazim italian, me prapashtesën turke -xhi ‘ai që ushtron një zeje’: ST 206 jolixhinjtë ‘ahengxhinjtë’.

Vetëm në idiolektin e Kokalarit, pra në tekstin informues e argumentues, ndeshen barbarizma italiane për mjedisin e banesës: F2 XXVI kuzinë ‘cucina’ (venec.); gatesat: F2 XIX biskote ‘biscoto’ (venec.), XXIX makarona ‘macaron’ (venec.); petkat e materialet: F2 VII napë ‘nappa’, XXXV i pantallonave ‘pantalone’; V kastor ‘castoro’; njësi matjeje: F2 IX metër ‘metro’, XXVI ora ‘ora’; terminologji e aspekte të jetës shoqërore: F2 XXVII ekonomi ‘economia’, XXV model ‘modello’, P 301 fanatizmit ‘fanatismo’, 299 kontrate ‘contratto’, F1 63 intriga ‘intrigo’, P 302 familja ‘famiglia’, P 301 sakrificave ‘sacrificio’. Mbiemrat: P 301 oriental ‘orientale’ e F2 XXIX elegant ‘elegante’; folja: F2 XVII sakrifikoi ‘sacrificare’.

Huazimet italiane që regjistrohen për herë të parë në tekstin narrativ janë ST 195 kalcat ‘calza’ dhe 122 dupje ‘dopia’ (venec.) Po kështu, futen së pari në tekstin informues: F2 XVIII asonancë ‘assonanza’ e XVI petales ‘petalo’. Këto 4 leksema shënohen dhjetë vjet më vonë në FGJSH.

Shpesh huazimi italian, më i njohur, përdoret në tekstin informues për të shpjeguar një huazim grek a turk të tekstit narrativ: ST 86 skami (gr.) në F2 XXXII sqarohet me leksemën karrigë ‘carega’ o ‘cariega’ (venec.); ST 167 Texhara (turq.) në F2 XXXV me operator (kirurg) ‘operatore’; SM 59, ST 24 hatëre (turq.) në F1 59 e F2 VIII me vizita ‘visita’. Shpjegimet e zërave ST 49 sapima me stofë ‘stoffa’, në F2 XXXII, dhe ST 264 Samur (turq.) me peliçe ‘pelliccia’, në F2 V, bëhen me dy italianizma që Autorja fut për herë të parë në shqipe.

Në një rast të vetëm italianizmi i tekstit argumentues zëvendëson huazimin grek të tekstit narrativ: Kokalari zgjedh huazimin e hershëm venecian P 300 Rruga ‘ruga’ në vend të greqizmit ST 5 udhë. Ndërsa trajta ST 22 lejmon ‘λεμόνι’, 170 lejmuja, formë e përgjithësuar në tekstin narrativ, nuk zëvendësohet me limon ‘limone’, që nuk del fare në vepër. Në ST 19 venecianizmi bocë shpjegohet me turqizmin shishe në F2 V, i përgjithësuar e mbizotërues në gjuhë.

Të rralla janë kalket nga italishtja. Tre i përkasin dialektit: RV 14 (nga) ndënë shkalla ‘sottoscala’; 12 mos më humbasësh ‘non perdermi’ (folja humbas nuk përdoret me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në shqipe) dhe SM 8 arritnë qiellin me dorë ‘toccare il cielo con un dito’; dhe i fundit, i vetëm, është i idiolektit të Kokalarit: P 297 Duke mbaruar ‘concludendo’.

Si përfundim, veprat e Musine Kokalarit i kalojnë pa dyshim caqet e një krijimi thjesht letrar, sepse përbëjnë një makrostrukturë të artikuluar në tri mikrostruktura: teksti narrativ, teksti informues dhe teksti argumentues. Veçantia qëndron në faktin se hartimi i këtyre tri teksteve është bërë në dy variante gjuhësore: teksti narrativ në gjuhën-dialekt, teksti informues e argumentues në gjuhën-idiolekt.

Rrugëtimi është nga idiolekti te dialekti, jo e kundërta. Arsyeja është autobiografike. Idiolekti i Kokalarit ka për bazë të folmen gjirokastrite, gjuhën e nënës. Kur botohen përmbledhjet me tregime, gjuha e nënës, pa u zvetënuar, ishte lëvruar e pasuruar natyrshëm në bankat e shkollës në Tiranë, me leximet personale e gjatë studimeve universitare jashtë shtetit dhe ishte shndërruar në një variant gjuhësor mbidialektor, pra idiolekt letrar erudit. Kokalari zgjedh ta ‘mbështjellë’ gjuhën e vet të përpunuar me veshjen dialektore gjirokastrite, si e dinte dhe si e kujtonte, për ta rrëfyer qytetin e lindjes në mënyrë më të efektshme e të besueshme. Kjo ka bërë që shpesh idiolekti mbidialektor t’i mbivendoset pavetëdijshtëm artificit gjuhësor gjirokastrit që Autorja vetë kishte krijuar.

Ky qëndrim gjuhësor ‘jobesnik’ i Kokalarit i jep së folmes gjirokastrite statusin e gjuhës së shkruar, pra mundëson kalimin nga tradita gojore te teksti letrar i përpunuar. Dhe me të vërtetë, ky hulumtim krahasues i veprës letrare të Shkrimtares me traditën gjuhësore gjirokastrite, krahas karakteristikave fonetike të përbashkëta, ka nxjerrë në pah dukuri të veçanta që nuk regjistrohen në Atlasin dialektologjik e në studimin e Totonit. Tipologjia tekstuale narrative i jep dorë Autores të kridhet në leksikun dialektor, por nuk mungojnë dhe shembujt e bjerres së krahinorizmave, falë përdorimit të lentimeve moderne dhe të huazimeve të nevojshme mbarëgjuhësore.

Idiolekti letrar erudit i Musine Kokalarit, me tiparet gjuhësore të përgjithësuara, edhe pse jo të qëndrueshme për shkak të ndërndikimeve përgjithësisht fonetike e morfologjike, por edhe sintaksore e leksikore të të folmeve dialektore, është dëshmi e modernizimit të gjuhës shqipe dhe e letrarishtes që po kristalizohej në kapërcyell të viteve ‘40.

Bibliografi, shkurtime e shkurtesa

AD = Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, I-II, Akad. e Shkencave e Shqipërisë, Napoli 2007 (I), 2008 (II).

Çabej = Çabej E., Studime etimologjike në fushë të shqipes, Tiranë, II/1976; IV/1996; VI/2002.

Dashi B., Italianismi nella lingua albanese, Roma 2013.

Dizdari T. N., Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë 2005.

F1 = Kokalari M., Fjalor te Siç më thotë nënua plakë.

F2 = Kokalari M., Fjalor' i librit te ...sa u tund jeta.

FGJSH = Fjalor i gjuhës shqipe, Instituti i Shkencave, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë 1954.

Lala L., Tipi di testo, Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano, II, Roma 2011: 1490-1495.

Lambertz1 M., Grammatik und albanische Texte, I-II, Leipzig 1948. Botohen: Mos qofshin vjehrat e zeza, Kulloi odaja, Për mustaqet e Çelos, Ulurima e qenit, I: 328-39 (shqip); II: 254-71 (gjermanisht).

Lambertz2 M., Zur albanischen Umgangssprache, «Lingua Posnaniensis», VII, 1958: 85-144.

Leotti A., Dizionario albanese-italiano, Istituto per l'Europa Orientale, Roma 1937.

Meyer G., Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache, Strassburg 1891.

P = Kokalari M., Duke mbaruar..., Psthënie në ...sa u tund jeta.

RV = Kokalari M., Reth vatrës, Tiranë 1944.

SM = Kokalari M., Siç më thotë nënua plakë, Tiranë 1939.

ST = Kokalari M., ...sa u tund jeta, Tiranë 1944.

Totoni M., Vëzhgime rreth së folmes së qytetit të Gjirokastrës,
«Studime filologjike», 1, Tiranë 1966: 77-119.

Visaret e Kombit, III-IV, Tiranë 1937-1939.

Abstract

This study aims to compare the literary work of Musine Kokalari with the way of speaking of Gjirokastrë. The phonetic phenomena and the lexicon analyzed highlight the concordances and differences between the written language and oral tradition. The dialect and idiolect are conditioned by the Author's intellectual stature.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

Musine Kokalari, vetëdija e shkrimit dhe e qëndresës : konferencë shkencore : në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Musine Kokalarit : Tiranë, 10 shkurt 2017 / Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" ; përg. prof. dr. Persida Asllani ; red. Loreta Loli. – Tiranë ; Prishtinë : BK ; BKK "Pjetër Bogdani", 2018 ... f. : me fotot e ekspozitës ; ... cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4494-0-5

ISBN 978-9951-13-076-9

I.Kokalari, Musine për atë

1.Letërsia shqipe 2.Kritika, interpretimi 3. Gra autore
4.Persekutimi politik 5.Antropologjia 6.Konferenca

821.18 (062)

929(496.5) [Kokalari, Musine] (062)